



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:229409  
Datë: 18.12.2023  
Numri i dokumentit: 05084116

**C-IV-14-6042**

*Ankuesi*

**B T**, fshati B, Drenas.  
*Përfaqësuar nga H H, avokat nga Glllogoci.*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 15 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN035-0693 i datës 20 gusht 2014 si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 03 shtator 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN035-0693 i datës 20 gusht 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në periudhën 2003 – 2005 në shumë prej 2,845.75 €, nga NJP ”Gurthyesi” njësi punuese e NSH “Ramiz Sadiku” Prishtinë. Ankuesi theksoi se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike qëndron në rrethanën se me datë 23 qershor 2014 ankuesi është njoftuar për pagat e papaguara në shumën e lartcekur, kështu që pas plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm ankuesi ka bërë kërkesë me kohë për pagat e papaguara, mirëpo zyrtari i pranimit të dokumentacionit të nevojshëm si duket e ka përcjellë me vonesë kërkesën e ankuesit, prandaj pa fajin e tij është dëmtuar nga papërgjegjësia e zyrtarit për pranimin e dokumentacionit dhe sot po i vuan pasojat e mos marrjes së pagave. Ankuesi pohon se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka për pasojë edhe zbatimin

e gabuar të së drejtës materiale në dëm të palës së dëmtuar, sepse gjendja faktike e mbijetesës së tij të të ardhurave është mjaft e rëndë, prandaj kërkoj nga Dhoma e Posaçme që ta rishqyrtoj çështjen e pagave të papaguara dhe në përputhje me afatet ligjore ta prish vendimin për refuzimin e pagave të papaguara. Ankuesi më tej pohoi se Dhoma e Posaçme duhet të kërkoj dëshmi dhe përgjegjësi edhe nga zyrtari për pranimin e dokumentacionit të punonjësve, se me ç' datë e ka pranuar kërkesën e dorëzuar nga ankuesi. Ankuesi i propozon gjykatës që nga arsyet e cekura më lartë dhe bazuar në provat në shkresat e lëndës që ankesën ta miratoj si të bazuar dhe ta prishë aktvendimin datë 20 gusht 2014 dhe të vendos në mënyrë meritore për pagat e papaguara. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij dorëzoi dëshmitë në kopje si: Autorizimin për përfaqësim, Vendimin e kundërshtuar, Kërkesën e AKP drejtuar ankuesit për të sqaruar paraqitjen me vonesë të kërkesës në AL nr.6482/2 datë 08 korrik 2014, Deklaratën e tij të datës maj 2014, Letërnyoftimin dhe dëshmi për pagesën e taksës gjyqësore.

Me 16 dhjetor 2020, e paditura parashtroi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura do të provoj dhe parashtroj se ankesa është e pabazuar dhe e pavlefshme dhe se shprehimisht e kundërshton kërkesën si të pabazuar për shkak se AL ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore të aplikueshme lidhur me kërkesën e ankuesit. Pasi që në bazë të dispozitave të procedurës civile kontestimore, ankuesi ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe Neni 23 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034), i mbetet ankuesit që të vërtetoj shkeljen e ligjit dhe konstatimin e gabuar të cilin e pretendon se ka bërë AL. Përveç se është e pabazuar, ankesa dhe argumentet e ankuesit janë të pavlefshme kurse arsyetimi ligjor i vendimit është i bazuar në fakte të verifikuara dhe një lexim korrekt i Ligjit 04/L-034. Bazuar në kërkesën e paraqitur nga parashtruesi në datë 23 qershor 2014, AL i ka dërguar një letër ankuesit që të justifikoj parashtrimin e kërkesës me vonesë. Ankuesi më datë 08 korrik 2014 përgjigjet me një fletë deklarate ku thotë se e jap dhe e nënshkruaj me përgjegjësi morale, materiale dhe penale këtë deklarate se është interesuar për dorëzimin e kërkesës edhe i është thënë se afati për dorëzimin e kërkesave është me 20 gusht 2007. Neni 35.3 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në mund të pranoj një kërkesë të dorëzuar pas afatit për parashtrim vetëm *“nëse një kreditor paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar... AL në diskrecion vetanak, mund të paranojë dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për parashtrimin e kërkesave, nëse dëshmia e kërkesës është parashtruar jo më vonë se 30 ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave”*. Justifikimi i tillë për AL nuk është i arsyeshëm e as bindës. AL ka publikuar në mënyrë të rregullt njoftimet e likuidimit dhe në internet nga dy herë dhe të gjithë ankuesit potencial kanë pasur mundësinë e barabartë për të paraqitur kërkesat e tyre në likuidim me afat prej 2 muajsh. E paditura shprehimisht e kundërshton ankesën si të papranueshme për shkak se ankuesi nuk e ka plotësuar ankesën me dokumentacionin e nevojshëm, në këtë rast nuk ka bashkangjitur justifikimin e besueshëm se pse kërkesa është dorëzuar me vonesë, siç e parasheh ligji 06/L-034 në nenin 35.3 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën e ankuesit si të pabazuar dhe të pavlefshme në zbatim të Nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 dhe të vërtetoj vendimin e AL në zbatim të Nenit 74.4 të Ligjit nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur në kopje: Vendimin për emërimin e anëtarëve të AL datë 30 shtator 2020.

Me 12 prill 2021, përfaqësuesi i ankuesit në përgjigje të urdhrorit të gjykatës për dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të ankesës së tij, dorëzoi: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit datë 27 qershor 2006 lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) dhe autorizimin për përfaqësim.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN035-0693, datë 20 gusht 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për pagat e pa paguara në shumë prej 2,845.75 €, në periudhën 2003 – 2005 nga NSH “Ramiz Sadiku” (në likuidim).

Ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit të AL, as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime/punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara për periudhën kohore 2003 – 2005, në shumë prej 2,845.75 €. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas pranimit të urdhrorit të gjykatës.

Në përgjigjen e tij në urdhrin e gjykatës të datës 15 mars 2021, përfaqësuesi i ankuesit dorëzoi vetëm Njoftimin për Përfundimin e Punësimit për ankuesin lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 27 qershor 2006. Sa i përket Njoftimit për Përfundimin e Punësimit datë 27 qershor 2006, gjykata konsideron se një dokument i tillë (si i vetëm) është dëshmi e pa mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara sipas vendimit të kundërshtuar.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara për periudhën kohore 2003 – 2005, në shumë prej 2,845.75 €, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar